

DO TË DOJE MË SHUMË INFORMACION?

Na vizito online

regioneer.it/colon



ose na telefono në numrin pa pagesë

800 033 033

çdo ditë nga ora 8:30 deri në 18:00 dhe
të shtunën nga ora 8:30 deri në 13:00.



**ËSHTË I THJESHTË, FALAS
DHE MUND TË TË SHPËTOJË
JETËN.**

SI TË MBLEDH NJË KAMPION TË FEÇES PËR TESTIN E GJAKUT TË FSHEHTË



1 Të është dhënë një paketë që përmban një shishkë dhe një qeskë plastike.



2 Së pari, mblidh një kampion në një enë të pastër e të thatë (p.sh. Plastike, letre ose alumini) ose vendosni letër tualeti në tualet ose në bide për të marrë feçen.



3 Më pas, hapni shishkën, duke bërë kujdes që të mos derdhet lëngu brenda saj.



4 Më pas fute shkopin në 3-4 pika të ndryshme të feçes.



5 Një sasi e vogël feçe duhet të qëndrojë tek shkopi.



6 Tani mund ta vendosësh shkopin sërish në shishkë dhe ta mbyllësh atë me kujdes.

7 Shishka duhet të vendoset më pas në qeskën e marrë në dorëzim dhe të ruhet në frigorifer derisa ta dorëzoni brenda tre ditësh.

- Nuk është e nevojshme të ndiqet ndonjë dietë specifike para mbledhjes së kampioneve të feçes.
- Kampionet e feçes nuk duhet të merren gjatë menstruacioneve.
- Kampioni duhet të dorëzohet në oraret dhe vendet e specifikuar në letrën e ftesës, brenda 3 ditësh maksimumi nga mbledhja.
- Gypin e testit përdoreni mundësisht brenda 3 muajsh nga marrja në dorëzim.